REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 322, 323, 326/20
Datë/Datum. 15.07.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.322/20
323/20
326/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "IPE CONTROLS-ING SH.P.K"-Gjilan, OE "IPE- PROING SH.P.K"-Prishtinë, si dhe ankesës së OE "ELT-KOSOVA & A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000" - Fushë Kosovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: NSH "IBMS; N.N Sh.Geokos A & A për Lot 1 dhe OE "IMK BALLKAN PROJEKT SH.P.K" për Lot 2, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, në projektet e infrastrukturës rrugore - LOT 1,2", me nr. të prok: "205-19-1724-2-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Infrastrukturës /MI/, më datën: 08.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: "IPE CONTROLS-ING SH.P.K" – Gjilan, dhe OE "IPE- PROING SH.P.K" – Prishtinë dhe ankesa e operatorit ekonomik "ELT-KOSOVA & A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000" - Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, në projektet e infrastrukturës rrugore- LOT 1,2", me nr. të prok: "205-19-1724-2-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Infrastrukturës /MI/.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për **LOT 1** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, në projektet e infrastrukturës rrugore- LOT 1,2", me nr. të prok: "205-19-1724-2-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Infrastrukturës /MI/ dhe lënda kthehet në **Rivlerësim për Lot 1.**

III. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për **LOT 2** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, në projektet e infrastrukturës rrugore- LOT 1,2", me nr. të prok: "205-19-1724-2-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Infrastrukturës /MI/. **Vërtetohet për Lot 2.**

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues IPE CONTROLS-ING SH.P.K"-Gjilan, ankesa e operatorit ekonomik "ELT-KOSOVA & A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000" - Fushë Kosovë dhe OE "IPE-PROING SH.P.K"-Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "IPE CONTROLS-ING SH.P.K"-Gjilan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 22.05.2020 me nr.322/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, në projektet e infrastrukturës rrugore- LOT 2", me nr. të prok: "205-19-1724-2-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Infrastrukturës /MI/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:1, 7, 59, 60, 64, 68, 69 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe vendimi i OSHP-së Nr.459,460-19 i dt:11.09.2019.

Operatori ekonomik ankues "IPE- PROING SH.P.K" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.05.2020 me nr.323/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, në projektet e infrastrukturës rrugore- LOT 1,2", me nr. të prok: "205-19-1724-2-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Infrastrukturës /MI/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59 dhe nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues OE "ELT-KOSOVA & A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000"-Fushë Kosovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.05.2020 me nr.326/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, në projektet e infrastrukturës rrugore", me nr. të prok: "205-19-1724-2-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Infrastrukturës /MI/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 6, 7, 59, 60, 61, 69, 70 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.06.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore për lëndën 327/20.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt:11.06.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor të OE "IPE-CONTROLS" se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit 9.1& 9.2 që lidhet me stafin e kërkuar inxhinieret dhe tekniket e ndërtimtarisë, eksperti shqyrtues ka dhëne mendim për këtë çështje në raportin e mëhershëm i cili është përfshirë edhe në vendimin e OSHP nr.459/19, 460/19. Ky pretendim është i përsëritur. Kjo është çështje e trajtuar dhe gjykuar me vendimin nr. 459-460/19 nga paneli shqyrtues "res judicata" sipas nenit 105 të LPP-së pika 2.16. Pretendimi është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Sa i përket pretendimit tjetër të OE "IPE CONTROLS" se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat financiare të pikës 8.1&8.2 të dosjes së te tenderit ku janë kërkuar Deklaratat tatimore vjetore të ATK-së sepse këto deklarata nuk janë të nënshkruara dhe të vulosura nga ATK, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. OE i rekomanduar për kontratë për LOT 2 me ofertë ka dorëzuar Deklaratat tatimore për tri vitet e fundit sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Deklaratat në fjalë janë me logo origjinale të ATK-së. Në kërkesën e dosjes së tenderit nuk është kërkuar që këto deklarata të janë të nënshkruara dhe vulosura. Prandaj në mënyrën si janë

kërkuar në dosjen e tenderit dhe një njoftimit për kontratë, ato janë ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për këtë Lot. Eksperti shqyrtues nuk ka vërejt asnjë element të dyshimtë në këto deklarata. Si i tillë ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmimin e njëjtë si pa TVSH si me TVSH dhe dyshojmë se ka manipulime të çmimeve, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Në listën e çmimeve të OE fitues për Lot 2 e cila është dorëzuar me ofertë në platformën elektronike shihet se çmimet janë të dhënë për njësi në secilin pozicion duke përfshirë edhe çmimet e peshuara. Në tabelën përfundimtare në rekapitullim, shumë çartë shkruan "çmimi për njësi me TVSH i peshuar". Pra, nga kjo shihet se për secilin pozicion ku është shkruar çmimi është i përfshirë edhe TVSH-ja. Pra, çmimet janë dhënë me TVSH brenda. Kjo është në rregull. Prandaj, edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

OE "IPE PROING"

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor se AK na ka eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se ne nuk jemi përgjigjur në kërkesën për sqarim për çmime jo normalisht të ulëta. Problemet që lidhen me user të kompanisë tonë platformën elektronike, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Ky aktivitet i prokurimit është tejzgjatur dhe janë nxjerr disa raporte të ekspertit shqyrtues dhe vendime të OSHP-së ku është trajtuar çështja e çmimeve jo/normalisht të ulëta. Eksperti shqyrtues ka dhënë mendim në raportin e më hershëm për çmimet e ofertës së OE ankues në këtë rast që është përshkruar edhe në vendimin e OSHP-së nr.459, 460/19. Mirëpo, pavarësisht kësaj, sipas vendimit nr.84-101/20 të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit lënda është kthyer në rivlerësim. Procesi i rivlerësimit nënkupton që i tërë aktivitetit duhet të vlerësohet nga një komision i ri i vlerësimit të ofertave. Komisioni i ri i vlerësimit ka të drejta të plotë për gjithë procesin e vlerësimit duke përfshirë edhe kërkesat për sqarime të çmimeve që ju drejtohen OE, si në rastin konkret. Pretendimi i OE ankues se çështja e userit për kompaninë e tyre të regjistruar në platformën elektronike ka ndikuar në mos përgjigjen në kërkesën e AK për sqarime të çmimeve jo/normalisht të ulëta, për mendimin e ekspertit shqyrtues nuk është arsyetim. AK ka vepruar njëjtë edhe me operatorët e tjerë ekonomik. Vetëm OE ankues në fjalë nuk i ka kthyer përgjigjeje AK në pyetjen për çmimet jo/normalisht të ulëta. Për këtë rast "Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët (B57)" neni 4.3 thotë: "Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet". Mbi këtë bazë autoriteti kontraktues e ka refuzuar ofertën e OE ankues "IPE PROING" sepse nuk ka marrë përgjigjeje në pyetjen për sqarime shtesë që lidhet me çmimet jo/normalisht të ulëta. Prandaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Sa i përket pretendimit tjetër ankimor se AK ka marrë vendim me datë 07.05.2020 ti shpërblej me kontratë dy OE, njërin për Lot 1 dhe tjetrin për Lot 2 edhe pse të njëjtit operator me vendimin e datës 24.01.2020 të AK-së janë cilësuar si tenderues të pa përgjegjshëm dhe me çmime manipulative. Pra, vendimi i fundit i AK-së bie ndesh me vendimin e datës 24.01.2020, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Arsyeja pse dy vendimet e AK për shpërblim me kontratë të operatorëve ekonomik, janë ndesh njëri me tjetrin është për shkak se për vendimin e AK-së të datës 24.01.2020 ka pasur dy ankesa në OSHP, pikërisht nga dy operatorët ekonomik që tani janë shpërblyer me kontratë dhe me vendimin nr.84-101/20 të OSHP-së lënda është kthyer në rivlerësim. Për këtë arsye dy vendimet e AK-së bien ndesh njëri me tjetrin, si rezultat i vendimit të OSHP-së. Këto raste janë të rëndomta në procedurën e prokurimit dhe parashihen edhe me ligj të prokurimit. Ndryshimi i vendimit të AK-së është bërë me qëllim të zbatimit të vendimit të OSHP-së. Prandaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit pika 9.1&9.2 që ka të bëjë me stafin e kompanisë, lidhur me inxhinierët dhe laborantët, eksperti shqyrtues ka dhënë mendim për këtë çështje në raportet e më hershme, pra ky është pretendim i përsëritur i cili është gjykuar nga paneli shqyrtues "res judicata" sipas nenit 105 të LPP-së pika 2.16. Pretendimi është i bazuar.

"ETL-KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000"

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues "ETL-KOSOVA" se oferta e tyre është eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet, nuk është evidentuar anëtari i konzorciumit "A.L.T.E.A & Geostudio 2000" në sistemin elektronik, ne deklarojmë që të dy anëtarët e konzorciumit jemi të regjistruar në sistemin elektronik. Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues ka dhënë mendim në raportin e datës 06.12.2019 dhe është konfirmuar edhe me vendimin e OSHP-së nr.815-825-818-832/19. Pra, ky pretendim është i përsëritur i cili është gjykuar nga paneli shqyrtues "res judicata" sipas nenit 105 të LPP-së pika 2.16. OE ankues për këtë çështje është i pa përgjegjshëm. Pretendimi është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1. "IMK Balkan Projekt" të paktën 17 prova nga lista e provave të kërkuara në DT nuk i ka të akredituara, deklarata e menaxherit nuk përmban as datë as titull të projektit për të cilin është emëruar, inxhinierët e caktuar për Lot 1 Kadri Morina nuk e ka të nënshkruar CV-në, po ashtu z. Burim Binaku i caktuar si laborant për Lot 1 ka shkollën e mesme të xehetarisë, etj. Eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Ky pretendim është gabimisht i paraqitur nga OE ankues sepse fitues

për Lot 1 nuk është OE "IMK Balkan Projekt" por fitues në këtë lot është "IBMS & Geokos A&A". Prandaj, nuk mundet të shqyrtohet ky pretendim ankimor.

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Sa i përket pretendimit të fundit ankimor të OE ankues për Lot 2 se OE i rekomanduar për kontratë "IBMS & Geokos A&A" i mungon aneksi i akreditimit e cila është pjesë e certifikatës së akreditimit, ku mundet të shihet se për cilat prova është i akredituar. Ky konzorcium ka të paktën 40 prova të pa akredituara, këtij OE i mungojnë pajisjet laboratorike siç është kërkuar në FDT, marrëveshja e ofruar me një operator slloven për pajisje nuk është e noterizuar, çështja e menaxherit që e ka CV të pa nënshkruar, etj. Eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Edhe ky pretendim i OE ankues ne fjale është gabimisht i paraqitur sepse për Lot 2 dy nuk është fitues OE "IBMS & Geokos A&A" por fitues ne këtë lot është OE "IMK Ballkan Projekt". Prandaj nuk mundemi te shqyrtojmë as këtë pretendim ankimor.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Ky aktiviteti i prokurimit është tej zgjatur dhe janë nxjerr tri vendime të OSHP-së, tani është në ankesë për të katërtën herë. Është i çuditshëm fakti se të tre operatorët ekonomik ankues aktual janë shpallur të pa përgjegjshëm me vendimin e AK-së të datës 24.01.2020 dhe asnjëri nga këta tre operatorë ekonomik nuk ka paraqitur ankesë në OSHP. Që do të thotë janë pajtuar me vendimin e AK të datës 24.01.2020 për eliminimin e ofertave të tyre. Pra, në këtë rast nuk kanë qenë palë me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-së. Me vendimin e AK të datës 24.01.2020 nuk ishin pajtuar dy OE aktual të rekomanduar për kontratë dhe të njëjtit kishin paraqitë ankesë në OSHP. Këto dy ankesa ishin aprovuar me vendimin e panelit shqyrtues nr.84-101/20 dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim. Pas rivlerësimit të ofertave, AK merr vendimin e datës 07.05.2020 dhe rekomandon për kontratë dy operatorë ekonomik. Tani përsëri paraqesin ankesë të tre OE ankues aktual. Kjo gjendje e ka komplikuar mjaftë situatën. Gjate rivlerësimit nuk janë respektuar ne tërësi dispozitat e nenit 59 të LPP-së. Bazuar në sqarimet e dhëna më lartë, eksperti shqyrtues, megjithatë i vlerëson pjesërisht të bazuara ankesat e OE "IPE-CONTROLS-ING" dhe OE "IPE PROING" ndërsa refuzohet si e pa bazuar ankesa e OE "ETL-KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000". Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që aktivitetin e prokurimit "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, ne projektet e infrastrukturës rrugore" Lot 1 dhe Lot 2 me nr. prok.205/19/1724/211 ta kthej në Rivlerësim dhe të veproj në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 12.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "IPE CONTROLS-ING SH.P.K" - Gjilan, me datë: 15.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "IPE- PROING SH.P.K" - Prishtinë, me datë: 12.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "ELT-KOSOVA & A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000"-Fushë Kosovë, me datë: 15.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesat e operatorëve ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "IPE CONTROLS-ING SH.P.K" - Gjilan se OE "IMK BALLKAN PROJEKT SH.P.K" i rekomanduar për kontratë për Lot 2 nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit 9.1& 9.2 që lidhet me stafin e kërkuar inxhinieret dhe tekniket e ndërtimtarisë. Paneli Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar "IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. përveç teknikut të laboratorit Burim Binaku i cili është teknik i xehetarisë dhe punon në laborator te OE IMK BALLKAN PROJEKT SH.P.K. ka të prezantuar edhe 6 teknik të tjerë të ndërtimtarisë, e të cilët janë: Shaban Ismajli - Bechelor i ndërtimtarisë (laborant), Vehbi Zullufi - Teknik (laborant), Zeqir Leci - Teknik i ndërtimtarisë (laborant), Sherif Thaqi - Bechelor i ndërtimtarisë (laborant), Nysret Bekteshi -Teknik i ndërtimtarisë (laborant) dhe Armend Sadiku - Bechelor i ndërtimtarisë (laborant). Pra, këta persona janë duke punuar dhe janë të caktuar me vendim të OE si teknik të ndërtimtarisë për projektin me titull: "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, ne projektet e infrastrukturës rrugore" dhe me nr. të prokurimit: 205-19-1724-2-1-1, duke ju precizuar detyrat dhe përgjegjësit që kanë. Andaj AK ka vlerësuar drejtë sipas nenit 59 të LPP.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "IPE CONTROLS-ING SH.P.K" - Gjilan" se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat financiare të pikës 8.1&8.2 të dosjes së tenderit ku janë kërkuar Deklaratat tatimore vjetore të ATK-së sepse këto deklarata nuk janë të nënshkruara dhe të vulosura nga ATK. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se OE i rekomanduar për kontratë për LOT 2 me ofertë ka dorëzuar deklaratat tatimore për tri vitet e fundit sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Deklaratat në fjalë janë me logo origjinale të ATK-së. Në kërkesën e dosjes së tenderit nuk është kërkuar që këto deklarata të janë të nënshkruara dhe vulosura. Prandaj, në mënyrën si janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe një njoftimit për kontratë, ato janë ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për këtë Lot. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se nuk janë vërejt elemente të dyshimta në këto deklarata. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues "IPE CONTROLS-ING SH.P.K" - Gjilan se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmimin e njëjtë si pa TVSH si me TVSH dhe dyshojmë se ka manipulime të çmimeve. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se në listën e çmimeve të OE fitues për Lot 2 e cila është dorëzuar me ofertë në platformën elektronike shihet se çmimet janë të dhënë për njësi në secilin pozicion duke përfshirë edhe çmimet e peshuara. Në tabelën përfundimtare në rekapitullim, shumë qartë shkruan "çmimi për njësi me TVSH i peshuar". Pra, nga kjo shihet se për secilin pozicion ku është shkruar çmimi është i përfshirë edhe TVSH-ja, çmimet janë dhënë me TVSH brenda. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "IPE - PROING SH.P.K" - Prishtinë se AK na ka eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se ne nuk jemi përgjigjur në kërkesën për sqarim për çmime jo normalisht të ulëta. Problemet që lidhen me user të kompanisë tonë platformën elektronike. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky aktivitet i prokurimit është tej zgjatur dhe janë nxjerr disa raporte të ekspertit shqyrtues dhe vendime të OSHP-së, ku është trajtuar çështja e çmimeve jo/normalisht të ulëta. Paneli Shqyrtues në vendimet e mëhershme ka sqaruar për çmimet e ofertës së OE ankues, konkretisht për këtë çështje është sqaruar edhe në vendimin e OSHP-së nr.459, 460/19. Mirëpo, pavarësisht kësaj, sipas vendimit nr.84-101/20 të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit lënda është kthyer në rivlerësim. Për më tepër, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se procesi i rivlerësimit nënkupton që i tërë aktivitetit duhet të vlerësohet nga një komision i ri i vlerësimit të ofertave. Komisioni i ri i vlerësimit ka të drejta të plotë për gjithë procesin e vlerësimit duke përfshirë edhe kërkesat për sqarime të çmimeve që ju drejtohen OE, si në rastin konkret. Pretendimi i OE ankues se çështja e userit për kompaninë e tyre të regjistruar në platformën elektronike ka ndikuar në mos përgjigjen në kërkesën e AK për sqarime të çmimeve jo/normalisht të ulëta, nuk është arsyetim. AK ka vepruar njëjtë edhe me operatorët e tjerë ekonomik. Vetëm OE ankues në fjalë nuk i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktues në pyetjen për çmimet jo/normalisht të ulëta. Për këtë rast "Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët (B57)" neni 4.3 thotë: "Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet". Mbi këtë bazë, autoriteti kontraktues e ka refuzuar ofertën e OE ankues "IPE PROING" sepse nuk ka marrë përgjigje në pyetjen për sqarime shtesë që lidhet me çmimet jo/normalisht të ulëta. Prandaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankues "IPE - PROING SH.P.K" - Prishtinë se AK ka marrë vendim me datë 07.05.2020 ti shpërblej me kontratë dy OE, njërin për Lot 1 dhe tjetrin për Lot 2 edhe pse të njëjtit operator me vendimin e datës 24.01.2020 të AK-së janë cilësuar si tenderues të pa përgjegjshëm dhe me çmime manipulative. Pra, vendimi i fundit i AK-së bie ndesh me vendimin e datës 24.01.2020. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se arsyeja pse dy vendimet e AK për shpërblim me kontratë janë ndesh njëri me tjetrin është për shkak se për vendimin e autoritetit kontraktues të datës 24.01.2020 ka pasur dy ankesa në OSHP, pikërisht nga dy operatorët ekonomik që tani janë shpërblyer me kontratë dhe me vendimin nr.84-101/20 të OSHP-së lënda është kthyer në rivlerësim. Për këtë arsye dy vendimet e AK-së bien ndesh njëri me tjetrin. Këto raste janë të rëndomta në procedurën e prokurimit dhe parashihen edhe me ligj të prokurimit. Ndryshimi i vendimit të AK-së është bërë me qëllim të zbatimit të vendimit të OSHP-së. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "IPE – PROING SH.P.K." – Prishtinë se është për tu habitur se si OE N.SH IMBS & NNSH GEOKOS A&A shpërblehet me kontratë nga AK edhe pse i njëjti formularin e paraqitjes së tenderit nuk e ka plotësuar dhe nënshkruar si duhet. Ky fakt dëshmohet në raportet e vlerësimit të përpiluara nga vetë AK, ku në të gjitha raportet e vlerësimit OE N.SH IMBS & NNSH GEOKOS A&A vlerësohet me (JO) në rubrikën tek "formulari i paraqitjes së tenderit i plotësuar dhe nënshkruar si duhet". Ndërsa, në raportin e vlerësimit të datës 07.05.2020 i njëjti OE në rubrikën "formulari i paraqitjes së tenderit i plotësuar dhe nënshkruar si duhet" vlerësohet me (PO). Pra, shihet se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së në raportin e vlerësimit të ofertave. Për sqarim rubrika për të cilën po flasim plotësohet dhe nënshkruhet vetëm në momentin e dorëzimit të ofertave në platformën elektronike, çdo plotësim ndryshim i mëvonshëm cilësohet si ndërhyrje dhe shkelje e nenit 7 të LPP-së. Paneli Shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron se autoriteti kontraktues gjatë ri-vlerësimit të ofertave duhet të verifikoj këtë pretendim ankimor dhe jep sqarime për këtë pikë ankimore.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "IPE – PROING SH.P.K." – Prishtinë se OE N.SH IMBS & NNSH GEOKOS A&A nuk ka ofruar dëshmi mbi pronësinë e pajisjeve laboratorike siç është kërkuar në FDT. Si rezultat i kësaj, në kuadër të FDT ka prezantuar një marrëveshje bashkëpunimi me një laborator të huaj. Marrëveshja e nënshkruar midis IBMS dhe laboratorit IRM nuk është bërë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate dhe nuk është bërë në emër të konsorciumit por është bërë vetëm midis IBMS dhe IRM me datë 07.06.2018, dhe e njëjta nuk është e noterizuar siç kërkohet në dosjen e tenderit. Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar dhe se AK me rastin e rivlerësimit duhet të verifikoj nëse kjo marrëveshje është konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e fundit të operatorit ekonomik ankues "IPE - PROING SH.P.K" - Prishtinë se OE "IMK BALLKAN PROJEKT SH.P.K" i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit pika 9.1&9.2 që ka të bëjë me stafin e kompanisë, lidhur me inxhinierët dhe laborantët. Paneli Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar "IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. përveç teknikut të laboratorit Burim Binaku i cili është teknik i xehetarisë dhe punon në laborator te OE IMK BALLKAN PROJEKT SH.P.K. ka të prezantuar edhe 6 teknik të tjerë të ndërtimtarisë, e të cilët janë: Shaban Ismajli - Bechelor i ndërtimtarisë (laborant), Vehbi Zullufi - Teknik (laborant), Zeqir Leci - Teknik i ndërtimtarisë (laborant), Sherif Thaqi - Bechelor i ndërtimtarisë (laborant), Nysret Bekteshi -Teknik i ndërtimtarisë (laborant) dhe Armend Sadiku -Bechelor i ndërtimtarisë (laborant). Pra, këta persona janë duke punuar dhe janë të caktuar me vendim të OE si teknik të ndërtimtarisë për projektin me titull: "Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, ne projektet e infrastrukturës rrugore" dhe me nr. të prokurimit: 205-19-1724-2-1-1, duke ju precizuar detyrat dhe përgjegjësit që kanë. Andaj AK ka vlerësuar drejtë sipas nenit 59 të LPP.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "ETL-KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000" se oferta e tyre është eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet, nuk është evidentuar anëtari i konzorciumit "A.L.T.E.A & Geostudio 2000" në sistemin elektronik, ne deklarojmë që të dy anëtarët e konzorciumit jemi të regjistruar në sistemin elektronik. Lidhur me këtë pretendim ankimor, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se mendimi nga eksperti dhe sqarimet nga paneli shqyrtues janë dhënë më herët përmes vendimit Psh.nr.815-825-818-832/19. Pra, ky pretendim është i përsëritur i cili është gjykuar nga paneli shqyrtues "res judicata" sipas nenit 105 të LPP-së pika 2.16. OE ankues për këtë çështje është i pa përgjegjshëm. Andaj, pretendimi është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "ETL-KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000" se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1. "IMK Balkan Projekt" të paktën 17 prova nga lista e provave të kërkuara në dosje të tenderit nuk i ka të akredituara, deklarata e menaxherit nuk përmban as datë as titull të projektit për të cilin është emëruar, inxhinierët e caktuar për Lot 1 Kadri Morina nuk e ka të nënshkruar CV-në, po ashtu z. Burim Binaku i caktuar si laborant për Lot 1 ka shkollën e mesme të xehetarisë, etj. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky pretendim është gabimisht i paraqitur nga OE ankues sepse fitues për Lot 1 nuk është OE "IMK Balkan Projekt" por fitues në këtë lot është "IBMS & Geokos A&A".

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues "ETL-KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000" për Lot 2 se OE i rekomanduar për kontratë "IBMS & Geokos A&A" i mungon aneksi i akreditimit e cila është pjesë e certifikatës së akreditimi, ku mundet të shihet se për cilat prova është i akredituar. Ky konzorcium ka të paktën

40 prova të pa akredituara, këtij OE i mungojnë pajisjet laboratorike siç është kërkuar në FDT, marrëveshja e ofruar me një operator slloven për pajisje nuk është e noterizuar, çështja e menaxherit që e ka CV të pa nënshkruar, etj. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se edhe ky pretendim i OE ankues në fjalë është gabimisht i paraqitur sepse për Lot 2 dy nuk është fitues OE "IBMS & Geokos A&A" por fitues në këtë lot është OE "IMK Ballkan Projekt".

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorëve ekonomik ankues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave për LOT 2 ka vepruar konform nenit 59 të LPP-së. Kurse, sa i përket pretendimeve ankimore për LOT 1, Paneli Shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që gjatë ri-vlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së, dhe njëherit të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Ministria e Infrastrukturës

1x1 OE- "IPE CONTROLS-ING SH.P.K"-Gjilan,

1x1 OE "IPE- PROING SH.P.K"-Prishtinë

1x1 OE "ELT-KOSOVA & A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000"-Fushë Kosovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.